

Trajnimet për Trajnues

15. Trajnimet për trajnues

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022 të Akademisë së Drejtësisë, Trajnimet për trajnues do të kenë vëmendje të veçantë veçanërisht për avancimin e metodologjisë trajnuese bashkëkohore dhe jo vetëm përmes të cilave më pas do të sigurohet realizimi cilësor dhe efikas i Programit trajnues.

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OPDAT ka inicuar hartimin e Programit të Përhershëm për Trajnues gjatë vitit 2021, megjithatë për shkak të natyrës së programit dhe infrastrukturës ligjore duke përfshirë edhe rrethanat pandemike nuk ka pasur zhvillime në këtë drejtim. Meqenëse është prioritet për Akademinë që të ketë një program të përhershëm ky aktivitetet pritet të konkretizohet gjatë vitit 2022. Gjithashtu për vitin 2022 janë edhe projekte tjera të cilat do të mbështesin Akademinë e Drejtësisë fillimisht në rekrutimin e trajnuesve në fusha të ndryshme e më pas edhe në realizimin e trajnimit të trajnuesve. Detajet sa i përket aktivitetëve për trajnimin e trajnuesve gjenden si në vijim:

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me International Narcotics & Law Enforcement Affairs (INL) gjatë vitit 2021 do të realizojë procesin e rekrutimit të trajnuesve potencial në fushën e Ndërmjetësisë, kurse gjatë vitit 2022 do të fillohet me Trajnimet e Trajnuesve në fushën e Ndërmjetësisë, projekt i cili do të realizohet në 4 sesione trajnuese me nga 5-10 ditë, do zgjasë rreth 18 muaj deri në finalizim.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti “iPROCEEDS” gjatë vitit 2021 ka filluar procesin e rekrutimit të Trajnuesve potencial në fushën e Krimin Kibernetik, kurse gjatë vitit 2022 pritet të zhvillohen 2 Trajnimet të Trajnuesve më të specializuara në fushën e Krimin Kibernetik dhe Provave Elektronike.

Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti “Lufta kundër dhunës ndaj grave/dhunës në familje” synohet që organizohet edhe 1 Trajnim për Trajnues duke synuar që të specializohen edhe më tutje trajnerët e Akademisë së Drejtësisë.

Gjithashtu me projektin e PECK III nga Këshilli i Evropës parashihet të zhvillohen edhe 2 Trajnimet të Trajnuesve në fushën e Konfiskimit si dhe Trajnimi i Trajnuesve tek veprat e Pastrimit të Parave pa vepër bazë.